



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 21/23 Nr. i faq./Br.str./No.pg 25

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2, shkronja d), nenit 17 shkronja (h) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.8 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit me Nr. Reference 04/042 të dt. 02.02.2022, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.02.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP)

- Caktohet komisioni për përzgjedhjen e drejtorit/es dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP) në Komunën e Rahovecit që kanë konkuruar në konkurset e shpallura nga Drejtoria për Arsim, në këtë përbërje:**
 - 1.1. Vjollca Vuçitërna, Drejtoresh në Institucionin e Arsimit dhe Aftësisë Profesionale (IAAP);
 - 1.2. Erseka Cana, kryetare e Këshillit të Prindërve, anëtare;
 - 1.3. Anëtar i tretë vjen nga MASH-i sipas UA Nr. 151/2020 i dt. 22.12.2020
- Detyra e komisionit është intervistimi i kandidatëve që kanë konkuruar në konkurset e cekura në pikën 1 të këtij vendimi dhe në bazë të pikëve të fituara, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandojnë Kryetarit të Komunës emërim të kandidatëve më të suksesshëm për drejtor/eshë apo zëvendës drejtor/eshë e shkollës sipas konkursit.
- Obbligohet komisioni përzgjedhës që punët të kryej duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Mandati i komisionit përzgjedhës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është 1 (një) vit.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Arsim,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01Nr.25/23
Datë:28.02.2023

